



Qendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim

# AVOKUESI



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA

Perkrah  
OJQ-te



Vëllimi V • Numri 3 • Mars 2007

## PËRMBAJTJA

### Faqe 2

ATRC-ja trajnon zyrtarët komunal dhe OJQ-të për zgjidhje të konflikteve sociale

"Partners Kosova" është qendër për administrimin e konflikteve

Shoqëria civile kritikon qeverinë për "kaos urban" në Prishtinë

### Faqe 3

OJQ-të unifikojnë aktivitetet në Viti për të avokuar për qytetarët

Të rinj nga Evropa Lindore diskutojnë për vullnetarizëm gjatë një seminari në Athinë

Kërkim studimor mbi trafikimin e qenieve njerëzore

### Faqe 4

Personat me aftësi të kufizuara kërkojnë punësim nga qeveritë lokale

Shtet-bërja në Evropën Juglindore

Çka është shoqëria civile?

**Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj**

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

Rr. Agim Ramadani Nr. 15  
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë  
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810

## Debate publike të organizuara nga ATRC-ja

### Ekspertët u sqarojnë qytetarëve të Kosovës pakon e Ahtisaarit

*Ekspertë ndërkombëtar dhe vendor të pakos së Ahtisaarit u kanë bërë thirrje qytetarëve për paqe dhe stabilitet në kohën kur përcaktimi i statusit për të ardhmen e Kosovës është në fazën përfundimtare*

Përfaqësues të qeverisjes lokale dhe asaj qendrore, OJQ-ve, mediave dhe sektorit të biznesit në 25 qytete të Kosovës u është ofruar mundësia të informohen, shqetësimet e tyre të dëgjohen, dhe të bëjnë pyetje lidhur me përmbajtjen e propozimit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, gjatë 26 tryezave të rumbullakëta të organizuara nga ATRC-ja në muajin mars.

Këto tryeza janë mbajtur në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Novobërd, Kaçanik, Obiliq, Fushë Kosovë, Shtime, Klinë, Kamenicë, Graçanicë, Podujevë, Lipjan, Shtërpce, Istog, Suharekë, Rahovec, Viti, Sкендерaj, Malishevë, Partesh dhe Zveçan, në përpjekje për ti informuar organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët për propozimin e Marti Ahtisaarit, të dërguarit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për negociatat për statusin e ardhshëm të Kosovës.

"Pakoja e Ahtisaarit përbehet nga parimet e përgjithshme të cilat hapin rru-



Ekspertët u sqarojnë qytetarëve të Rahovecit pakon e Ahtisaarit më 27 mars

gën për shtet të pavarur të Kosovës", ka thënë Blerim Shala, koordinator i ekipit negociator të Kosovës më 7 mars në tryezën e mbajtur në Prishtinë. "Pakoja ruan kufijtë dhe i mundëson Kosovës të jetë tregim i suksesshëm".

Kryesuesi i Zyrës Britanike në Kosovë, David Blunt, ka deklaruar se pakoja e Ahtisaarit është rezultat i kompromisit dhe këndvështrimeve të kundërta. Sipas Bluntit, pakoja pasqyron këndvështrimet e shumicës dhe nevojën për mbrojtjen e minoriteteve.

"Decentralizimi në Kosovë është proces i njëjtë si në tërë Evropën" ka shtuar ai. Procesi i decentralizimit ka

qenë një ndër çështjet më preokopuese për shumicën e pjesëmarrësve.

Shtatë takime të mëdha rajonale të planifikuara për prill, do të pasojnë tryezat e lartpërmendura, për informim të mëtejshëm dhe të gjerë të opinionit për përmbajtjen e pakos së Ahtisaarit.

I dërguari i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së shpallosi propozimin e tij më 2 shkurt, pas një viti negociatash ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në Vjenë të Austrisë.

*Për propozimin e plotë të statusit, vizitoni [www.uno-sek.org](http://www.uno-sek.org)*

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

### Zhvillimi urban i Prishtinës

#### Shoqëria civile kritikon qeverinë për "kaos urban"



Përfaqësues të shoqërisë civile janë takuar më 15 mars në ATRC për të diskutuar zhvillimin urban të Prishtinës. Pjesëmarrësit fokusuan diskutimet në pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje për çështje me rëndësi urbane në Prishtinë. Ata kritikuan qeverinë lokale dhe atë qendrore për, siç thanë ata, "shkatërrimin e Prishtinës".

"Prishtina ballafaqohet me kaos urban. Kjo situatë sipas terminologjisë arkitekturale quhet stres urban", ka theksuar arkitekti Xhelal Llonqari.

Përfaqësuesit e "Iniciativës Qytetare për Mbrojtjen e Prishtinës" shprehën shqetësimet e tyre për "pjesëmarrjen e zyrtarëve komunal në ndërtimet pa leje në vend që të kujdesen për zhvillimin urban të Prishtinës".

Pjesëmarrësit po ashtu janë ankuar për shkatërrimin e vendeve me trashëgimi kulturore. "Qytetarët janë më të vetëdijësuar për mbrojtjen e këtyre vendeve sesa vet qeveria", ka thënë Baki Svirca, Drejtor i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore.

Njëzet e një monumente të trashëgimisë kulturore ekzistojnë në Prishtinë, sipas një hulumtimi të kryer nga Instituti Kosovar për Stabilitet.

## ATRC-ja trajnon zyrtarët komunal dhe OJQ-të për zgjidhje të konflikteve sociale

Trajnerët e ATRC-së kanë realizuar gjashtë trajnime për menaxhim të konflikteve, në rajonin e Prishtinës, Gjilanit dhe Pejës gjatë muajit mars. Trajnimet "Zgjidhja e konfliktit social në shumë nivele," në të cilat morën pjesë zyrtarë komunal dhe OJQ-të, synon t'i ndihmojë qeverisë lokale dhe shoqërisë civile në fuqizimin dhe forcimin e marrëdhënieve të tyre në mënyrë që të parashikojnë dhe tu përgjigjen më mirë nevojave të komuniteteve të tyre përmes mjeteve dhe teknikave për zgjidhje të konfliktit.

ATRC-ja beson se ndër-



Sesion trajnimi në Istog më 27 mars

timi dhe forcimi i marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy sektorëve mund të shërbejë edhe si bazë në përkrahje të projekteve të tjera që kanë të bëjnë me demokracinë dhe ruajtjen e paqes

në Kosovë. Kjo po realizohet përmes trajnimit të përfaqësuesve të qeverisë lokale dhe OJQ-ve për zgjidhje të konfliktit.

Trajnimet "Zgjidhja e konfliktit social në shumë nivele," përfshirë sesione që kanë të bëjnë me kuptimin dhe trajtimin e konfliktit, komunikimin, konfliktin social, ndryshimin dhe demokracinë, bashkëpunimin për zhvillim, etj.

*Kjo iniciativë është përkrahur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme.*

### Prezantim i një OJQ-je lokale

#### "Partners Kosova" është qendër për administrimin e konflikteve

"Qendra Partners-Kosova për Administrimin e Konflikteve" është organizatë jo-qeveritare e angazhuar për të avancuar shoqërinë civile, kulturën e ndryshimeve dhe administrimin e konflikteve.

"Partners-Kosova" është themeluar në vitin 2001 për të përhapur kulturën e zgjidhjes paqësore të konflikteve në Kosovë. Që atëherë, kjo qendër ka punuar me qytetarët e Kosovës të të gjitha etniteteve për të ndihmuar zgjidhjen e konflikteve dhe për të arritur konsensus në fushat e fqinjësisë, biznesit, marrëdhënieve shumicë-pakicë dhe qytetarë-qeveri. Qendra ofron shërbime nga ndërmjetësimi deri tek kurset e

trajnimit për jo diskriminim dhe integrim etnik. "Partners-Kosova" ka ndihmuar në zgjerimin e pranimit të zgjidhjeve alternative dhe paqësore të konflikteve në shoqëri.

Fushat kryesore të punës së kësaj qendre janë: ndërmjetësimi, reformimi i qeverisjes lokale, integrimi etnik & zgjidhja e konflikteve. Programet kryesore përfshijnë shërbimet e ndërmjetësimit; programin e qeverisjes vendore; dhe



"Partners-Kosova" është OJQ vendore e themeluar në vitin 2001 për të përhapur kulturën e zgjidhjes paqësore të konflikteve në Kosovë

programin e të rinjve dhe femrave udhëheqëse.

*Për më shumë informata, vizitoni: [www.partnerskosova.org](http://www.partnerskosova.org)*

## OJQ-të unifikojnë aktivitetet në Viti për të avokuar për qytetarët

### Publikim i ri


#### Kërkim studimor mbi trafikimin e qenieve njerëzore

Partneriteti kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (PATH), projekt ky i përkrahur nga USAID dhe implementuar nga Catholic Relief Services dhe Kosova Population Foundation, kanë publikuar më 22 shkurt raportin "Kërkim Studimor mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore."

Studimi, i realizuar gjatë dhjetorit 2006 dhe janarit 2007, synon të mësohen njohuritë, qëndrimet, dhe perceptimet e audiencave të ndryshme lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Kosovë. Rezultatet e studimit do të përdoren për dizajnimin dhe përmbajtjen e fushatës së gjerë mediale të PATH projektit. Ky humlumtim do të shërbejë edhe si pikë nisje prej nga do të matet efikasiteti i përpjekjeve për të përmirësuar informimin e qytetarëve, në kuadër të Planit për Veprim të Qeverisë për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Studimi është realizuar përmes dy sondazheve, një me popullsinë në përgjithësi dhe tjetra me vajza të reja të moshës 14-18 vjeç, dhe bazohet në intervistat me 500 kosovarë.

Shumica e të intervistuarve kanë dëgjuar për trafikimin e qenieve njerëzore ...

*Për raportin e plotë, vizitoni [www.kopfund.org](http://www.kopfund.org)*



OJQ-të në Viti 'Elita,' 'Legjenda,' 'Aster,' 'Organizata e Pavarur e të Rinjve,' 'Rrjeti Rinor,' dhe 'Shoqata për Ambient dhe Natyrë' kanë formuar koalicionin më 7 mars

OJQ-të në komunën e Vitit, qytet ky në lindje të Kosovës, besojnë se problemet e qytetarëve mund të zgjidhen me fushata të fuqishme avokimi. Ata janë në dijeni që shoqëria civile të ketë ndikim në procesin e vendimmarrjes, OJQ-të duhet të flasin me një zë. Kështu, më 7 mars OJQ-të në Viti unifikuan aktivitetet e tyre në kuadër të një koalicioni përmes së cilit ata synojnë të avokojnë për qytetarët.

OJQ "Elita" ka iniciuar themelimin e këtij koalicioni,

përkrahur nga ATRC-ja dhe IREX në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile. Emrush Azemi nga Elita ka veçuar se ky koalicion do të avokoj për zgjidhjen e "shumë problemeve në Viti nga institucionet e pushtetit lokal".

"OJQ të ndryshme në Viti kanë identifikuar shumë probleme që mund të zgjidhen, nëse ekziston vullnet në mesin e institucioneve. Ne (OJQ-të) besojmë se një fushatë e fuqishme avokimi do të shtonte presionin ndaj zyrtarëve komu-

nal për zgjidhjen e këtyre problemeve", ka thënë Azemi.

Sipas tij, implementimi i rregullores së Kuvendit Komunal për trafik; implementimi i ligjit për barazi gjinore; funksionimi i zyrës ligjore të Asamblesë Komunale; pjesëmarrja më e madhe e të rinjve në procesin e vendimmarrjes; përmirësimi i higjienës në dy shkollat fillore të qytetit; janë çështjet për të cilat do të avokoj koalicioni OJQ-ve.

Melihate Osmani, koordinatore e shoqatës së gruas "Legjenda" ka theksuar se shoqëria civile ka qenë aktivisht e angazhuar në çështje avokuese në Viti "mirëpo rezultatet kanë munguar sepse këto aktivitete nuk kanë qenë të unifikuara brenda organizatave të shoqërisë civile. Koalicioni i ri është një hap i madh përpara".

*Për më shumë informata, vizitoni [www.elita-viti.org](http://www.elita-viti.org)*

## Të rinj nga Evropa Lindore diskutojnë për vullnetarizëm gjatë një seminari në Athinë

Pesëdhjetë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe lëvizjeve vullnetare nga 26 vende të Ballkanit dhe zonave tjera të Evropës Lindore (përfshirë përfaqësues të Kosovës nga ATRC-ja dhe Avonet-i) janë takuar në Athinë të Greqisë për të këmbyer njohuritë dhe praktikën e zhvillimeve të fundit në fushën e vullnetarizmit.

Pjesëmarrësit u takuan prej 1 deri më 3 mars në një seminar të organizuar nga organizata shtetërore e Greqisë për vullnetarizëm Citizen in Deed. Ata patën mundësinë të këmbëjnë ide, përvoja, dhe të marrin

pjesë në një sërë ligjëratash, workshops të drejtuara nga akademikë dhe ekspertë të kësaj fushe. Seminari u përqendrua në iniciativat shtetërore; marrëdhëniet ndër-

kombëtare: Evropa Lindore dhe sektori i tretë; historia dhe teoria e shoqërisë civile; menaxhimi i OJQ-ve; puna vullnetare; etj.

"Në qoftë se nuk ke partnerë, nuk ekziston", ka pohuar profesor Pantelis



Vizita e pjesëmarrësve në Parlamentin grek më 1 mars

Sklias nga Universiteti Democritus i Thracit, duke iu referuar rëndësisë së partneritetit të efektshëm në mesin e organizatave të shoqërisë civile.


*Për më shumë informata, vizitoni [www.citizenindeed.org](http://www.citizenindeed.org)*

**atrc****Executive Director**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org**Financial & Administration  
Manager**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org**Grant Manager**  
TEUTA LUZHA  
teuta@advocacy-center.org**Grant Officer**  
KUSHTRIM KALOSHI  
kushtrimk@advocacy-center.org**Grant Officer**  
XHAFER AHMETI  
xhafer@advocacy-center.org**Grant Finance Manager**  
SAFETA XHEKOVIC  
safeta@advocacy-center.org**Training & Consultancy  
Services Manager**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
AFERDITA SURROI  
aferdita@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
KUSHTRIM ISLAMI  
kushtrim@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
NORA SUSURI  
nora@advocacy-center.org**Communication & Outreach  
Manager**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org**Program Officer**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org**IT and Database Manager**  
ARSIM KOSUMI  
arsim@advocacy-center.org

## Personat me aftësi të kufizuara kërkojnë punësim nga qeveritë lokale

Organizata e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë "Handikos" ka organizuar më 6 mars në Suharekë seminarin "Ngritja e vetëdijes publike për punësim të personave me aftësi të kufizuara në komunitet e Kosovës". Seminari ka pasur për qëllim edhe shqyrtimin e mundësive për krijim të rrjeteve dhe koalicioneve me qëllim të shtimit të aktiviteteve në përkrahje të personave me aftësi të kufizuara.

Organizuesit veçan rëndësinë e organizimit të trajnimeve për personat me aftësi



të kufizuara me qëllim të avancimit të tyre profesionalisht, dhe krijimin e rrjeteve dhe koalicioneve në mesin e kësaj shtrese të shoqërisë për përfaqësim më të mirë dhe realizim të të drejtave të tyre. Pjesëmarrësit kërkuar nga institucionet qeverisëse lokale që të jenë të vendosur në përmirësimin e ambientit për lëvizje të lirë të personave me aftësi të kufizuara, në punësimin dhe avancimin e tyre profesionalisht. Qendra e Handikosit në Suharekë ka 520 anëtarë. *Seminari është përkrahur nga ATRC-ja dhe IREX-i.*

### Projekt i ri

## Shtet-bërja në Evropën Juglindore

"Procesi i shtet-bërjes në Evropën Juglindore" është projekt studimor i cili ekzaminon katër procese specifike të shtet-bërjes në Evropën Juglindore pas vitit 1945: rasti i boshnjakëve, maqedonasve, malazezëve dhe moldavëve. Hulumtimi fokusohet në perceptimet popullore të shtet-bërjes. Si janë ballafaquar njerëzit e 'zakonshëm' në këto katër vende me përpjekjet komuniste dhe pas-

komuniste të shtet-bërjes; a janë përjashtuar ose ndryshuar nocionet zyrtare të identitetit (të ri) kombëtar? Në çfarë mënyrë është arritur identifikimi me shtetin e ri, siç është shtetëzimi i praktikave kulturore, si kurse edhe simbolet?

Duke siguruar perspektivat historike dhe antropologjike, ky studim krahasues i proceseve të fundit të shtet-bërjes synon të qes në pah njohuri të reja

shkencore.

Projekti është implementuar nga Instituti për Studime të Evropës Lindore në Berlin dhe Departamenti për Histori të Evropës Juglindore në Universitetin e Grac-it.

*Për më shumë informata për këtë projekt, vizitoni: <http://www.oei.fuberlin.de/en/projekte/nation-building/>\**

## Çka është shoqëria civile?

Shpjeguar thjesht, shoqëria civile është hapësirë e ndërmjetshme në mes të qytetarëve dhe shtetit, e cila formohet nga organizatat vullnetare, klubet, sindikatat profesionale, institucionet kulturore dhe organizmat fetar. Kështu, shoqëria civile vepron si kundërpeshë e shoqërisë politike. Shoqëria civile mat zhvillimin kulturor dhe praninë e metodave demokratike në një shoqëri: sa më e zhvilluar të jetë shoqëria civile, aq më mirë funksionon demokracia. Koncepti modern i shoqërisë civile është formuar me tranzicionin nga shoqëria tradicionale në atë moderne. Në këtë mënyrë, ajo lidhet me nocionin e modernizimit...

*ATRC-ja do të dëshirojë të publikoj këndvështrimet e lexuesve në këtë pyetje, prandaj opinionet tuaja janë të mirëseardhura (ju lutem na shkruani në [info@advocacy-center.org](mailto:info@advocacy-center.org))*

